



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 07.06.2023

## Procesverbali i dëgjimeve Buxhetore për kornizën afatmesme buxhetore 2024 – 2026 me përfaqësuesit e Kuvendit Komunal dhe Komitetet

Vendi i takimit:

Salla e Kuvendit Komunal

Ora:

13:00

Përfaqësuesit institucional:

Latif Ramadan, Visar Kozhani

Pjesëmarrësit

Përfaqësuesit e Kuvendit Komunal dhe  
Komitetet

Përgatitja e procesverbalit

Grupi punues për hartimin e planifikimit të  
projekt buxhetit 2024-2026

Numri i pjesëmarrësve:

11

Burra:

6

Gra:

4

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhet dhe Financa Latif Ramadani, ka bërë hapjen e takimi dhe ka prezantuar planifikimin e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024-2026.

Gjatë këtij takimi drejtori për Buxhet dhe Financa ka prezantuar planifikimin e buxhetit të Komunës së Lipjanit dhe ka pranuar të gjitha kërkesat që kanë dalur nga këto takime. Ai po ashtu ka inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë sa më shumë në këto takime sepse kanë rëndësinë e veçantë dhe është mundësia më e mirë për përfshirjen e kërkesave të qytetarëve. Si dhe ka falënderuar për pjesëmarrjen në takimin e parë për kornizën afatmesme buxhetore 2024 – 2026 me theks të veçantë investimet kapitale dhe investimet tjera të cilat do ti bëj komuna për gjatë viteve 2024 – 2026.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### Pyetjet e qytetarëve:

**Shahajdiye Dragaqina** – Kërkesa për asfaltimin e rrugës Ganimete Terbeshi në Lipjanit, asfaltimin e rrugës Hanrovc, si dhe fasadimin e objekteve banesore të mbeturës së fasadohen ndërsa grat të cilat kanë pësuar dhunë të ju ndahet një shumë për mbështetjet dhe personat me astësi të kufizuar kanë shprehur dëshirë që ti mbështesim për bajë apo për ndonjë shëtitje.

**Besjana Syla** – Kërkesë e imja dhe banoreve të fshatit Banull është rregullimi i urës, tek lagjëja Syla dhe Haliti, kërkesa e dytë asfaltimi i rrugës së lamës të cilën e ka parashtruar prindi, sipas procedurave administrative nuk i kanë kthy as një përgjigje, tjeter është një rrugicë të rruga Haxhi Zeka në fshatin Gllogoc kish me qenë mirë me u përfshi në projekt.

**Genta Hoxha** – Kërkoj asfaltimin e rrugës kryesore në Topliqan së bashku me trotuar dhe ndriçim asfaltimin e rrugës Topliqan që e lidh me fshatin Kojiske dhe asfaltimin e rrugicave në fshatin Topliqan Dobraj dhe Magure.

**Lulzim Rrustemi** – Buxheti është mirë mu orientu në arsim, ka nevojë për kabinete, prioritet për vitin e ardhshëm tek projektet që i kam has gjatë mbajtës së mbledhjeve nëpër fshatra, në Kleqkë e kemi një telash me kanalizim edhe disa rrugica të vogla të cilët ata kanë problem ndër fqinjësore, Rubofci i Vogël kërkesë për asfaltim të rrugica dhe një pjesë të kanalizimit, ura e cila lidh Rufcin me Hallaqin e Vogël në drejtim të rrugës Maria Shllaku, të ujësjellësi komuna ka pak kompetenca po është mirë ujësjellësi që ka filluar për Krajsht Ribar është mirë me pas parasysh me nda mjete aq sa i lejohet komunës edhe për cilat fusha i lejohet komunës me nda mjete për ujësjellës edhe në Burs edhe Akllap, fushat e futbollit për me i ik asfaltit edhe betonit me u bo me bari sintetik ose goma.

**Alban Salihu** – Po pajtohem me Lulin për sektor që kanë nevojë për investim, të këto investim infrastrukturore besoj që secili kemi mundësi me gjetë rrugë e rrugica për me ndërhy unë nuk e di pse në listën e dëgjimeve buxhetore nuk është parapa një takim me këshillat e fshatareve edhe investimi për fshatra me ardh kryesisht prej këshillave të fshatrave. Ish kanë mirë me pas një takim me këshillat e fshatrave.

**Ganimet Qeriqi** – Rruga tek varrezat e cila lidhet prej shtëpisë së Medi Qeriqit edhe shkon andej ka Pjetershtica me qenë se aty kemi mendu me emëru atë rrugë me emrin e një gruaje dhe është mirë të jetë fokus në të ardhmen për me u asfaltua.

**Hasan Luma** – Duke e parë që po hartohet korniza afatmesme buxhetore andaj kërkoj që shuma të rritet për zyrën për barazi gjinore e dyta të ndahen më shumë mjete në drejotratin e kulturës për ndarjen e fondevë për klubet të cilat janë vetëm femra.

**Rinor Murati** – Kërkesa për fshatin Kojskë si dhe Rubovc i Madh dhe Rubovc i Vogël është ndërtimi i trotuarit në tri fshatrat.